

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-23-9425-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	NNT "Milazim Shala"
NUI	810249640
Adresa	Rruga "Fehmi Lladrofc" nr. 11
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	044/166063
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Faton Shala
Adresa elektronike	m.shaladrenas@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	29.11.2023

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për anulim është me datë 24.11.2023 nga AK Drenas

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Neni 56, Neni 59, Neni 60 dhe Neni 62 të LPP-së dhe Neni 43, i rregullores 01/2022.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me poshte gjeni te listuara te gjitha argumentat per pikat per te cilat ju na keni eliminuar me pretekstin se nuk jane ne dosjen e tenderit apo nuk kemi paraqitur si informacion apo dokumentacion tek AK.

1. Sipas dosjes se tenderit nuk eshte e specifikuar qe te gjitha kompanite duhet te jene te certifikuar me ISO standarte, sipas dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontratë, neni 7.1 & 7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pika 3 thotë Kompania duhet te jete e certifikuar me ISO 9004-2015 (Quality management System) – Kopje. Pra nuk e specifikon që kërkohet për Liderin apo për të gjithë antarët e konzorciumit.

2. Sipas kërkesës ne kemi bashkangjitur dokumentacionin e inxhinierit Hekuran Demiri bachelor i diplomuar në gjeodezi i cili është diplomuar në vitin 2013 në Universitetin e Prishtinës, që për të cilin nuk nevojitet nostrifikim i diplomës. Gjithashtu licenca e të punësuarit është valide deri më datë 24.05.2026.

3. Sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë , neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 5, ku kërkohet një inxhinier I diplomuar I ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknikë me përvojë pune 5 vite, sipas kriterëve nuk është caktuar përvoja e punës pas diplomimit. I njëjti ka 5 vite përvojë pune sipas CV. Nëse do ishte kërkuar njësoj sikurse tek pika 3 për inxhinierin e gjeodezisë do vlente ky kriter.

4. Gjithashtu edhe për inxhinierin e diplomuar të programit të mjedisit, nuk është kërkuar dëshmia e përvojës së punës pas diplomimit, e njëjta ka 5 vite përvojë pune sipas CV.

5. Sipas nenit 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 7 kërkohet një person përgjegjës nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale. Inxhinieri që ne kemi ofruar është I diplomuar në bachelor për siguri dhe shëndet në punë I njëjti është edhe i certifikuar.

6. Sipas nenit 9.1 & 9.2 Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 10 (2) janë kërkuar 4 Eskavatorë me peshë 18-20 ton, në dokumentacionin tonë si ofertues i gjeni të bashkangjitura si më poshtë.

Nga dokumentacioni i kompanisë NNT “Milazim Shala”

1. Eskavator CAT, Tipi 320BL 1997 i cili ka **20 ton**.

2. Akerman, Tipi H7C 1989 me **18 ton**.

Ndërsa tek kompania NPSH “Bageri” kemi të bashkangjitur

1. Eskavator Liebherr, Tipi A900C 2003 me **18 ton**,

2. Liebherr Tipi A904 Litronic, 1998 i cili ka **19.5 ton**,

3. Eskavator Liebherr, Tipi A904 Litronic 2002 i cili ka **19 ton**,

4. Eskavator Liebherr, Tipi A904, 1998 me **19 ton**.

7. Sa i përket kërkesës të nenit 9.1 & 9.2 Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 10 (5) është kërkuar një kamion kiper me kran me peshë ngarkese max.2 ton. Ne kemi ofruar një kamion kipper me kran, nuk mungon kjo makineri në dosjen tonë të ofruar tek ju.

Mos marrja parasyshë e këtij dokumentacioni që Ne ofrojmë do të konsiderohet si shkelje e LPP-së Neni 1, Neni 6 (dëmtim buxheti) Neni 7, Diskriminim I ofertuesit tonë dhe shkelje Neneve 59 dhe 60 tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin në përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet përshërbime të avokatisë dhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*